



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 19.

Prishtinë, më 28.07.2015 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić, Čerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha .

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Emrat e pjesëmarrësve në mbledhje : përfaqësues nga OSBE-ja Lejla Selimi, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 7.07/ 14.07/ dhe 15.07.2015
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor, me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-029 për Patenta, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;
6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;
7. Shqyrtimi i Projektligjit 05/L-15 për Letërnjoftim, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.07/ 14.07/ dhe 15.07.2015;

Kryesuesja – konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 7.07/ 14.07/ dhe 15.07.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor, me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin për shëndetin mendor dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për shëndetin mendor dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-029 për Patenta, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-029 për Patenta me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-029 për Patenta dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit 05/L-15 për Letërnjoftim, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin 05/L-15 për Letërnjoftim me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe propozim amendamentet e deputetit Nahit Hasani, dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim konkret në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin 05/L-15 për Letërnjoftim dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- III. Komisioni, shqyrtoi veçmas amendamentet e deputetit Nait Hasani dhe të njejtat nuk i përkrahu.

8. Të ndryshme

Jasmina Živković, informoi anëtarët e komisionit lidhur me situatën e krijuar në mbledhje të Komisionit për legjislacion, mandate, imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër korrupsionit, me ç'rast Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit, ka refuzuar dokumentin zyrtar nga Ministria për komunitete dhe kthim, me që logoja është e shkruar në alfabetin cirilik, me arsyetim se kjo është kundër Kushtetutës.

Duke marr parasysh se Kushtetuta dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve, garantojnë si gjuhë zyrtare gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe, andaj konsideron se interpretimi i komisionit legjislativ është i pa paraneshtëm dhe i pa përgjegjshëm.

Për situatën e krijuar, ajo propozoi që komisioni jonë të dalë me një komunikatë, drejtuar komisionit për legjislacion, Kryesisë së Kuvendit dhe Kryeministrit të Kosovës, që të kërkojmë interpretimin të drejtë ligjor.

Danush Ademi, në kuadër të legjislacionit, përdorimi i alfabetit cirilik është kundër kushtetues. Sipas mendimit të tij, për këtë çështje është dashtë të reagojë përfaqësuesja e komunitetit serb, Milena Milićević.

Agim Çeku, theksoi se në këtë rast është kontestuese çështja e përdorimit të alfabetit cirilik, edhe përkundër faktit se gjuha serbe është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës. Propozimi i tij ishte që të kërkohej interpretim juridike nga zyra ligjore e Kuvendit, më pas komisioni do të reagojë në marrjen e veprimeve tjera.

Agim Kikaj, pajtohet që për sqarimi të kësaj çështje të kontaktohet zyra ligjore e Kuvendit. Sipas mendimit të tij është kontestuese paraqitja e logos së Republikës së Kosovës, në alfabetin cirilik.

Pas diskutimeve, Komisioni për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthim nxori:

Përfundim

Qëndrimin i të gjithë anëtarëve të komisionit lidhur me përdorimin e alfabetit cirilik në logon e Republikës së Kosovës është që të kontaktohet Zyra për interpretim ligjor dhe pasi që merret përgjigjja e tyre, të reagohej në mënyrë adekuate, me qëllim që të ndërmerren hapat e duhur lidhur me këtë situatë.

Veton Berisha, informoi komisionin se lidhur me monitorimin e Ligjit për shërbimin civil, gjegjësisht neni 11, grupit punues ka pregaditur pyetësorin me numër të punësuarve në shërbimin publik dhe privat ku të njëjtin ia ka dërguar Ministrisë së Administratës Publike. Afati kohor për përgjegje është fillimi i muajit shtator. Si kërkesë e tij ishte që të ftohet ministri z.Mahir Jagcilar, në njërën nga mbledhjet e komisionit.

Ćerim Bajrami, në kuadër të monitorimit të ligjit për shërbimin civil, grupi punues në bashkëpunim me përfaqësuesit e OSBE-së është dakorduar të mbahet degjimi publik në fillim të muajit shtator. Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, u muar qëndrim që degjimi publik të mbahet me datën 9.10.2015.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković